



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr 3144 / Prot.
9

Patos, më 26 / 11 / 2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 25 NËNTOR 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 14:00

Ora e mbarimit: 15:30

Dëgjuesë publike me temë: “Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”.

Pjesëmarrës: Kryetar i bashkisë z. Fation Duro, Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretar e Këshillit znj. Refaela Xeba, Anëtarë të GMS dhe përfaqësues të bashkisë Patos, banorë, përfaqësues të institucioneve arsimore, anëtarë të KVR, të rinj të qytetit dhe nxënës të shkollave etj.

Në total: 84 pjesëmarrës

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit



Kryetari i Këshillit

z. Armand Ahmetaj

Dëgjese publike me temë:

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”, jemi këtu sot së bashku me të rinjtë dhe përfaqësues të institucioneve arsimore, për të prezantuar para jush dokumentin përfundimtar lidhur mbi buxhetin 2026 dhe PBA-në 2026-2028. Ftoj ekzekutivin të prezantoj materialin dhe sipas rregullave mund të drejtoni pyetjet tuaja më pas.

Drejtores e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari– prezanton materialin mbi buxhetin. Fjala si më poshtë:



Drejtores

Znj. Mimoza Shtëmbari

Dëgjese publike me temë:

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

Përshëndetje të gjithëve! Sot do prezantojmë materialin përfundimtar para jush. Për të qënë transparent edhe ju duhet të njiheni me treguesit financiar dhe parashikimet lidhur me buxhetin 2026. Pasi kemi kaluar një sërë dëgjësash dhe kemi marrë gjithë kërkesat tuaja në shqyrtim kemi arritur në një draft përfundimtar. Buxheti i vitit 2026 zë vlerën 733 milion e 839 mijë lekë. Ky buxhet përbëhet nga tre burime kryesore. Përbëhet nga të ardhurat, transfertat e kushtëzuara ose ajo sektoriale dhe ajo e pakushtëzuara. Peshat specifike për çdo

burim është, 45% mbulohen nga të ardhurat e buxhetit, 34% mbulohen nga transfertat e kushtëzuar dhe pjesa tjetër nga ajo sektoriale. Vlen për tu theksuar që jemi në rritje të të ardhurave nga buxheti total. Po ti referohemi peshës specifike që zënë investimet me të ardhurat kemi një raport 27% të të ardhurave që mbulojnë investimet me rritje nga 2025 kundrejt të ardhurave 45%. Një element i rëndësishëm është edhe shpërndarja e buxhetit sipas klasifikimit ekonomik ku 44.9% janë shpenzimet për pagat, 7.4 për sigurimet shoqërore etj. Duke bërë një krahasim të burimeve financiare për vitin 2026 me vitin 2025 kemi një rritje prej 8.5% të buxhetit. Buxheti i bashkisë është hartuar duke ndjekur strukturën organizative të hartuar nga Ministria e Financave që për herë të parë jemi nga 12 bashkitë e projektuara si bashki. E kemi ndarë buxhetin në 6 programe. Prioritetet e bashkisë vazhdojnë të jenë zhvillimi ekonomik urban, sporti dhe çështjet sociale dhe punët publike. Në vazhdim janë emërtimi i projekteve që do plotësojnë gjithë kërkesat e marra në dëgjuesat publike. Për pjesën e aktiviteteve që do të jenë edhe në mbështetje të rinisë ne kemi menduar dhe kemi buxhetuar investim për rikonstruksionin e aneksit të Patosit që konsiston me shtrimin e fushës me shtresat përkatëse, ndërhyrje në rrjetin e ndriçimit etj.

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Përshëndetje! Ju falenderoj që jeni bashkuar sot me ne. Ky është një takim i rëndësishëm për ne pasi një pjesë e projekteve të 2026 janë edhe pjesë e PBA-së. Të rinjtë janë një pjesë e rëndësishme dhe është me vlerë për ne të



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.
Nëntor 2025**

prezantojmë materialin e buxhetit para jush. Kryetari i bashkisë prezanton materialin dhe më pas kalon në diskutime. Fjala si më poshtë:

- Unë sot dua t'ju bëj një pyetje? Çfarë do të bënit ju si të rinj, nëse do të ishit kryetar bashkie dhe ku do ta fokusonit ju buxhetin e bashkisë?

Anëtar i KVR, Sokol Baxhia- Përshëndetje! Unë si një i ri, nëse do të isha kryetar bashkie, do të fokusoja buxhetin në zhvillimin infrastrukturor rrugor, pasi kjo është shumë e rëndësishme. Specifikisht do të doja të bëja ndryshime edhe në shkollë, në infrastrukturën e jashtme dhe në këndet sportive.



**Anëtar i KVR
Sokol Baxhia**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Ne kemi parashikuar investim në fushën e



**Kryetar i bashkisë Patos,
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-
2028”.**

Nëntor 2025

aneksit dhe do aplikojmë projektin lidhur me këtë. Është menduar edhe ndërtimi i dhomave të zhveshjes për të gjithë ata që do ta frekuentojnë. Në kemi bërë edhe lulishten te lagjja “1 Maj” që frekuentohet nga të rinjtë. Ne do të ndërtojmë në çdo lagje investime që do të frekuentohen nga të rinjtë. Investim tjetër është edhe fusha e zezë, e cila do të filloj shumë shpejt dhe do të ketë tre funksione me fushë basketbolli, futbollit dhe volejbollit. Është parashikuar edhe një park te lagjja e Re, por nuk e di sa do të realizohet me buxhetin e ardhshëm pasi kërkon fond të lartë, ka filluar edhe rikonstruksioni i shkollës “Sotir Çapo”. Kemi mbyllur dhe projektin e shkollës “Hekuran Maneku” dhe do aplikojmë të Ministria e Arsimit për rikonstruksionin e saj. Gjithashtu sa i përket arsimit po rikonstruktohet edhe kopshti Nr. 1 me drek që po përfundon dhe është parashikuar edhe rikonstruksioni i kopshtit Nr. 2. Unë kam shumë dëshirë që ju pas përfundimit të shkollës së lartë të riktheheni në Patos dhe të punoni. Detyra jonë është që kthimi juaj në këtë qytet të jetë i lehtë dhe ju të gjeni lehtësirat që do ju krijoj bashkia në infrastrukturë dhe çdo hap tjetër.

Nxënës e shkollës “Mustafa Matohiti”, Antonela Fasllaiaj– Përsëritje! Ne kemi problem të madh me transportin në Patosin Lart. Nxënësit nuk kam më çfarë të lëvizin nga

zonat ku banojnë në shkollë, apo nga banesa drejt qytetit. A do të gjendet ndonjë zgjidhje për transportin e nxënësve?



**Nxënëse e shkollës “Mustafa Matohiti”
Antonela Faslliaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

Zv/ Drejtore në shkollën “Sotir Çapo”, znj. Elsa Thanasi– Përhëndetje! Edhe unë si



**Zv/ Drejtore në shkollën “Sotir Çapo”
znj. Elsa Thanasi**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-
2028”.**

Nëntor 2025

mësuese dua të theksoj kërkesën e nxënëses, pasi edhe në zonën e Zharrëzës kemi të njëjtin problem me transportin. Ligji nuk e përmban rimbursimin e transportit për nxënësit e shkollës së mesme dhe nxënësit tanë që jetojnë zona periferike të Zharrëz preferojnë të shkojnë në Fier për të frekuentuar shkollën se sa në gjimnazin tonë pasi kostoja e transportit është më e ulët dhe për të ardhur në shkollën tonë nuk ka mundësi transporti. Duam të dim sa do të gjendet ndonjë mënyrë transporti edhe për Zharrëzën nga fshatrat deri të shkolla, në mënyrë që edhe numri i nxënësve të mos bjer. Të paktën të gjendet mundësia të rimbursohet gjysma e çmimit të rrugës.

Mësuese në shkollën “Muhamet Shehu”, znj. Vjollca Kasaj- A do të ketë ndonjë investim



**Mësuese në shkollën “Muhamet Shehu”
znj. Vjollca Kasaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin
2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

për Pallatin e Kulturës në Patos?

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Lidhur me Pallatin e Kulturës kërkon një



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-
2028”.**

Nëntor 2025

investim të madh për ndërhyrje dhe për momentin nuk kemi mundësi. Për sa i përket transportit të nxënësve ju vet e thatë që ligji nuk e përmban rimbursimin për nxënësit e shkollës së mesme. Në momentin që nuk është ligjore dhe në nuk e ndryshojmë dot si bashki. Lidhur me transportin në lagjen “Mustafa Matohiti” është prishur mjeti dhe nuk po rregullohet. Edhe kostoja që ka ai transport është goxha i lartë dhe aq lëvizje sa ka nuk i mbulon shpenzimet që ka ai mjet. Në do parashikojmë blerje e një tjetër mjeti që ta përdorim për transportin. Për sa i përket rrugës së Belinës e keni të parashikuar në buxhetin e vitit që vjen, por që fëmijët mos të largohen nga shkolla duhet një sforc jo vetëm na bashkia, por edhe nga vet stafi akademik.

Drejtoresh e shkollës “Meleq Gosnishti”, znj. Entela Kënaci- Përsëritet! Në shkollën



**Drejtoresh e shkollës “Meleq Gosnishti”
znj. Entela Kënaci**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

tonë ne kemi përsëri probleme me lagështirën dhe kemi nevojë prap për ndërhyrje me izolimin e taracës.

Drejtores e shkollës “Koli Dimo”, znj. Albana Xhemaj- Përsëritje! Edhe në shkollën tonë kemi probleme me lagështirën dhe ujë. Ambjenti kullon dhe përbën rrezik edhe për linjat elektrike. Kabineti i informatikës ka probleme dhe gjithashtu edhe rrjeti elektrik është shumë i dobët dhe ndriçimi shumë i keq, pasi nuk mbajnë çelësat. Nxënësit nuk shkruajnë dot me aq pak ndriçim. Edhe për pjesën e ngrohjes ne nuk i përdorim dot sobat me dru pasi mësuesit e kanë të vështirë sepse oxhakët janë të bllokuar.



**Drejtores e shkollës “Koli Dimo”
znj. Albana Xhemaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Në lidhje me problemet tuaja unë do vij dhe do



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

verifikoj këto probleme dhe do dërgoj punonjësit për ndërhyrje. Për pjesën e ngrohjes ne mund t'ju dërgojmë sobat me dru që ti përdorini për tu ngrohur dhe gjithashtu mund të bëjme dhe pastrimin e oxhakëve që të kaloj tymi.

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2026 dhe PBA-së 2026-2028”.**

Nëntor 2025

për komentet dhe sugjerimet tuaja. Nëse nuk keni diçka tjetër për të shtuar e deklarojmë të mbyllur këtë dëgjese.

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba



Koordinatorë e Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

